



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Eurofamis" Sh.A. të datës 19.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.06.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i fushave të futbollit në Bardhosh, Bërnice dhe Matiqan - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-4404-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Eurofamis" Sh.A. e datës 19.06.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.06.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i fushave të futbollit në Bardhosh, Bërnice dhe Matiqan - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-4404-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Eurofamis" Sh.A. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Eurofamis" Sh.A. (tutje "parashtruesi") me datë 19.06.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 19.06.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i fushave të futbollit në Bardhosh, Bërnice dhe Matiqan - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-4404-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Ne baze te analizes se bere Dosjes se tenderit dhe pershkrimet te cmimeve, del qeprojekti NUK e kishte vleren e parashikuar konform cmimeve te tregut. Me datë 19.06.2023, AK ka ANULUR përsëri këtë aktivitet të prokurimit dhe ne jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Por në arësyetimin e AK thuhet se ne kemi tejkaluar buxhetin për këtë projekt. Siq edhe mundë ta shihni, Operator Ekonomik të përgjeshëm janë dy operator dhe njëri operator ka vlerën e ofertës 182,296.70 Euro, ndërsa oferta e jonë është e përgjegjshme dhe ka çmimin prej: 179,048.88 Euro”*.

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 8, 9, 59 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 23.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

**Lidhur me pretendimet e parashtruesit:** fillimisht duhet theksuar se me datë 19.06.2023 është publikuar njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku është evidentuar se ky aktivitet i prokurimit anulohet *“për arsye se asnjëri nga ofertuesit nuk janë të përgjegjshëm”*. Një konstatim i tillë i autoritetit kontraktues është mbështetur në raportin e komisionit vlerësues ku është gjetur se asnjë nga tenderuesit nuk është i përgjegjshëm. Konkretisht sa i përket parashtruesit, komisioni vlerësues ka gjetur se me rastin e ofertimit parashtruesi *“ka bërë tejkalimin e vlerës së parashikuar”* ndërsa autoriteti kontraktues e ka të pamundur të tejkaloj vlerën e parashikuar për kontratë në mungesë të mjeteve buxhetore shtesë të planifikuara. Vlera e parashikuar për këtë kontratë ka qenë 150,000.00 Euro ndërsa parashtruesi ka dorëzuar ofertën me çmim 179,048.88 Euro respektivisht ka tejkaluar buxhetin e parashikuar për 29,048.88 Euro.

Duhet theksuar që vendimi i autoritetit kontraktues për të anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin si më sipër është bazuar në nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin 2 të LPP ku thuhet se *“Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës nëse të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit”* si dhe në nenin 43 paragrafin 43.5 pikën b të RRPP ku përcaktohet se *“Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet nëse asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm”*.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 23.06.2023**



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Kosova e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.